



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-8007/20 datë:29.05.2020



Npi – 01/112 datë: 10.06.2020

Duke u bazuar në nenin 12.2, pika (d) nenet 81 dhe 82 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, Qershor 2008); Kuvendi i Komunës së Shtimes, shqyrtoi kërkesën e Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, Nr.020-5/7 të datës: 06.02.2020 për rishikimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes Npi.01/389, që ka të bëjë me caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit publik për nevoja të komunitetit të fshatit Petrovë, në parcelën Nr.900-0 (1012-0 i ndryshuar), Z.K - Petrovë, me sipërfaqe prej 300 m². Kuvendi i Komunës, duke marrë për bazë Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Rekomandimin e Zyrtarit Ligjor, në mbledhjen e mbajtur më 10.06.2020, aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR ANULIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES
Npi – 01/389 TË DATËS: 23.12.2019

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -IV- të rregullt për vitin 2020, e mbajtur më 10.06.2020, me shumicën e votave vendosi të anulojë Vendimin e Kuvendit të Komunës së Shtimes, Npi-01/389, të datës 23.12.2019 për caktimin e lokacionit për objektin publik për nevoja të komunitetit të fshatit Petrovë, në parcelën Nr.900-0 (1012-0 i ndryshuar), Z.K-Petrovë, me sipërfaqe prej 300m², deri në miratimin e Planit Zhvillimor Komunal, (PZHK) dhe Hartave Zonale të Komunës së Shtimes, (HZK).

II

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palëve, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj